



Datë: 10.07.2025
Numër Protokolli: 4677/2025

A.nr.1871/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1871/2024, të datës, 10.12.2024, të parashtruar nga ankuesi G.B, kundër Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe kërkesës së datës 04.03.2025 për rihapjes të procedurës të parashtruar nga ankuesi për rihapje të procedurës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 10.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet Vendimi A.nr.1871/2024 i datës 13.02.2025 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

II. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1871/2024, e datës 10.12.2025, e parashtruar nga ankuesi G.B. **detyrohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi përmes aktit administrativ të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 03.12.2024 të ankuesit.

III Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, G.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), i punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil i Kosovës, më datën 10.12.2024 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin material të shtesave për vëllimin e punës, dhe shtesës për performancë mbi bazën juridike të Nenit 22 paragrafi 1 nën paragrafi 3 dhe 6 ndërlidhur me nenin 25 dhe 28 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, duke kërkuar te aprovohet ankesa si e bazuar dhe obligohet AAC te paguaj shtesën për pune dhe vëllim shtesa nga muaj nëntor 2019 deri ne muajin nëntor 2024 (te kompensohet 20% pagës për 60 muaj) dhe për vitin 2022 shtesa për performancën të shkëlqyeshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.01.2025 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (tutje AAC), ndërsa ky i fundit më datë 20.01.2025, ka përcjell përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto

prova: Ankesën me numër protokolli 6577/2025 të datës 10.12.2024 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Akt Emërimit e ankuesit të datës 28.02.2018; Certifikatën e datës 12.11.2019; Emailin e datës 09.12.2024 nga Sh.S për ankuesin dhe S.S; Emailin e datës 09.12.2024 nga ankuesi për Sh.S dhe S.S; Emailin e datë 09.12.2024 nga Sh.S për ankuesin; Emailin e datës 09.12.2024 nga S.S për ankuesin; Emailin e datës 03.12.2024 nga ankuesin për S.S; Emailin e datës 07.02.2024 nga S.S për ankuesin; Emailin e datës 07.02.2024 nga ankuesi për S.S; Emailin e datës 01.02.2024 nga A.R për Sh.S dhe S.S; Emailin e datës 01.02.2024 nga ankuesi për S.S; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.10.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 20.01.2025; Dëshmi për leje për qasje të përdoruesve në SIMFK datë 10.02.2024; Vendimin e datës 17.01.2023; Kërkesë për buxhet e datës 31.05.2023; Kërkesë buxhetore për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitin 2025 dhe 2026 e datës 26.06.2023; Kërkesë për buxhet për vitet 2024-2025 e datës 20.10.2023; Formularin e shpenzimit të departamentit, Divizionit dhe Sktrorit; Kërkesë buxhetore për vitin 2025 dhe vlerësimet 2026 dhe 2-27 e datës 27.06.2024; Kërkesë buxhetore për vitin 2025 pas pranimit të kufijve final e datës 15.10.2024; Vendimin A.nr.18712/2024 i datës 13.02.2025 i KPMSHCK-së; Kërkesën për rihapjen e procedurës e datës 04.03.2025 me provat e njëjta sikurse të ankesës së datës 10.12.2024.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se rasti i ankuesit, duhet të kthehet në detyrim për vendosje, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 28.02.2018, mban pozitën e punës *Zyrtar për rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigacionit ajrorë*, në AAC, ndërsa sipas Vendimit Nr. Ref:01/2023 të datës 17.01.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së është caktuar për ushtrimin e funksionit në qarjes në SIMFK në pozitën Zyrtar Zotues.

Ankuesi më datë 10.12.2024, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për mos kompensimin material të shtesave për vëllim të punës dhe shtesës për performancë mbi bazën juridike të Nenit 22 paragrafi 1 nën paragrafi 3 dhe 6 ndërlidhur me nenin 25 dhe 28 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, duke kërkuar te aprovohet ankesa si e bazuar dhe obligohet AAC te paguaj shtesën për pune dhe vëllim shtesa nga muaj nëntor 2019 deri ne muajin nëntor 2024 (te kompensohet 20% pagës për 60 muaj) dhe për vitin 2022 shtesa për performancën të shkëlqyeshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.02.2025 ka nxjerr Vendim A.nr.1871/2024, me të cilin ka hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit të datës 10.12.2024, duke konstatuar se ankuesi fillimisht nuk ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit lidhur me pretendimet për shtesat e kërkuara.

Ankuesi më datë 04.03.2025, ka parashtruar kërkesë për rihapje të procedurës administrative, me pretendimet se kërkesën e ka adresuar tek Njësia e Burimeve Njerëzore në AAC më datë 03.10.2024.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka pranuar kërkesën për rihapjen e procedurës administrative, konstaton se përveç materialeve të dërguar nga ankuesi sipas kërkesës për rihapje të procedurës i cili ka dërguar kërkesën e datës 03.12.2024 të dërguar për Njësinë e Burimeve Njerëzore të AAC-së, e njëjta provë ka qenë edhe me rastin e parashtrimit të ankesës së datës 10.12.2024, mirëpo që nuk është vërejtur nga ana e Kolegjit me rastin e vendimmarrjes. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se bazuar në gjendjen e fakteve të vlerësuara veç e veç dhe të gjitha së bashku, si dhe bazuar në nenin 140 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se ka bazë juridike kërkesa për rihapjen e procedurës administrative, ngase pala ankuese ka ofruar fakte të mjaftueshme që kërkesa e datës 03.12.2024 ka ekzistuar edhe në kohën e vendimmarrjes. Si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në nenin 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. 23. Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë*”, e për rrjedhojë mbi bazë të kuadrit ligjor si më lartë, bëhet shfuqizimi i Vendimit A.nr.1871/2024 të datës 13.02.2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit, konstaton se duke qenë se kemi ndryshim të rrethanave juridike në këtë çështje juridike administrative, meqë pala ankuese më datë 03.12.2024 ka parashtruar kërkesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore e AAC-së, duke kërkuar kompensimin për vëllim në punë dhe kompensimin e shtesës së performancës, Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore e AAC-së më datë 09.12.2024. ka njoftuar se edhe përkundër kërkesat për mjete shtesë nuk janë aprovuar kërkesat e tilla.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik në rast kur hapet një procedurë administrative pranë organit publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me kërkesën përmes emailit të datës 03.12.2024 të parashtruar nga ankuesi, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të shqyrtoj kërkesën e ankuesve të datës 03.12.2024 dhe të nxjerrë akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo brenda afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, mos përgjigja e organit të administratës përmes një akti administrativ në raport me kërkesën e datës 03.12.2024, të parashtruar nga ankuesi, cenojnë të drejtat e ankuesit në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjen në mënyrë meritore, ngase, ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar të organi i punësimit,

ankuesi pretendon në realizimin e disa të drejtave të cilat mendon se janë duke ju mohuar, apo janë duke ju shkelur, dhe për rrjedhojë edhe vendosjes në mënyrë meritore, ngase ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar të organi i punësimit, ankuesi pretendon realizimin e të drejtave të natyrës materiale duke u bazuar në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat e të Punësuarit në Sektorin Publikë.

Kështu që thënë si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën në kuptim të shkeljeve procedurale dhe si rrjedhojë detyroj Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të AAC-së që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj kërkesën e datës 03.12.2024 të ankuesit lidhur me kompensimin e funksionit shtesë dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1871/2024

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit G.B;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të AAC-së
- Arkivit të KPMSHCK-së.